



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2021:055214
Datë: 28.03.2024
Numri i dokumentit: 05520112

C.nr.135/21

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm/ Divizioni Civil, gjyqtari Petrit Curri në çështjen juridike kontestimore të paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KEDS) me seli në Bulevardin “Bill Klinton” nr.3, ndërtesa e Elektro-Kosovës, kati II, nr.5 Prishtinë, kundër të paditurit-tani të ndjerit I. Sh. nga fshati M.-Komuna e Malishevës, me objekt kontesti kompensim i dëmit material, vlera e kontestit 96.26 euro, jashtë seancës gjyqësore me datë 29.03.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. NDËRPRITET** procedura në këtë çështje juridike kontestimore me shenjën C.nr.135/21, sipas padisë së paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KEDS) me seli në Prishtinë, kundër të paditurit I. Sh. nga fshati M./Malishevë lidhur me kompensimin e dëmit material, për shkak të vdekjes së të paditurit.
- II.** Procedura e ndërprerë në këtë çështje do të vazhdohet kur trashëgimtari/trashëgimtarët e të paditurit apo kujdestari i pasurisë trashëgimore ta marrin përsipër procedurën, apo kur t'i thërrasë gjykata ta bëjnë këtë, me propozimin e palës kundërshtare.

A r s y e t i m

Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KEDS) me seli në Prishtinë, pranë kësaj gjykate me datë 19.03.2021 ka parashtruar padi ndaj të paditurit I. Sh. nga fshati M./Malishevë, me objekt kontesti “Kompensim i dëmit material”, me vlerë të kontestit 96.26 €.

Gjykata përmes aktvendimit procedural C.nr.135/21 të datës 12.02.2024, padinë me të gjitha shkresat e bashkangjitura ia ka dërguar të paditurit për përgjigje në padi, kurse me datë 28.03.2024 në ora 11:00, gjykata ka caktuar seancën përgatitore, ku i autorizuari i të paditurës përmes parashtrësës ka njoftuar se nuk mund të jetë prezent me arsyetimin se është i angazhuar në seanca tjera, ndërsa për të paditurin ka prezantuar bashkëshortja e tij, F. Sh..

Në këtë seancë, bashkëshortja e të paditurit e ka njoftuar gjykatën se bashkëshorti i tij I. Sh. ka vdekur para 4 viteve dhe si dëshmi, në gjykatë ka dorëzuar certifikatën e vdekjes me numër serik V ... të datës 28.03.2024.

Gjykata ka konstatuar se në bazë të certifikatës së vdekjes, me numër serik V ..., dhe me numër reference ... e lëshuar me datë 28.03.2024, vërtetohet se tani i ndjeri I. (R.) Sh. me numër personal ... i lindur me 26.09.1971 në M., ka vdekur me datë 28.07.2020 në M..

Me rastin e vënies në dijeni të këtij fakti, gjykata iu referua dispozitës së nenit 277 pika a) të LPK-së, e cila përcakton se: *“Procesi gjyqësor ndërpritet: a) kur pala ndërgjyqëse vdes ose e humbë zotësinë procedurale, e nuk ka të caktuar përfaqësues me prokurë në gjykim”*. Bazuar në faktin se Gjykata disponon me dëshmi shkresore në drejtim të argumentimit të faktit se i padituri I. Sh. ka vdekur dhe një rrethanë e tillë paraqet pengesë për procedim të mëtutjeshëm në këtë çështje kontestimore, andaj në kuptim të dispozitës së lartcekur nga neni 277 pika a) të LPK-së janë plotësuar prezumimet për ndërprerjen e procedurës.

Vendosjen si në pikën -II- të dispozitivit të këtij aktvendimi, Gjykata e mbështeti në dispozitën nga neni 280 par.1 të LPK-së, e cila përcakton se: *“Procedura që është ndërprerë për shkaqe të treguara në nenin 277 paragrafi 1 pika a)–d) të këtij ligji do të vazhdohet kur trashëgimtari, apo kujdestari i pasurisë trashëgimore, përfaqësuesi i ri ligjor, administratori i falimentimit apo pasardhësi juridik i personit juridik, e marrin përsipër procedurën apo kur i thërret gjykata ta bëjnë këtë, me propozimin e palës kundërshtare”*.

Gjykata vë në dukje se në kuptim të dispozitës nga neni 279 të LPK-së, si rezultat i ndërprerjes së kësaj procedure, rrjedhimisht ndërpriten edhe afatet për zhvillimin e veprimeve procedurale dhe gjatë kësaj kohe gjykata nuk mund kryej kurrfarë veprimesh procedurale, e po ashtu veprimet e kryera nga ndonjëra prej palëve ndërgjyqëse nuk prodhojnë kurrfarë efekti juridik ndaj palës kundërshtare, deri në momentin e vazhdimit eventual të procedurës.

Andaj, në një gjendje të këtillë dhe mbi bazën e të lartcekurave, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.135/21, datë 28.03.2024

G j y q t a r i
Petrit Curri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.